

AKT THEMELIMI

Sot, ne dt.27 Janar 2021 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

ARBRI FERKO, i biri i Resmi(ut) i datelindjes 12-09-1988, i lindur ne Fier dhe banues Fier,lagj.Mbrostar Ferko, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.Personal **035131454**,leshuar nga MB Tirane me date **18-11-2019**,

i cili me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtarete dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijone shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **VITAL INVEST Shpk.**

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **VITAL INVEST Shpk.** Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **VITAL INVEST Shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **VITAL INVEST Shpk**, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagjja Mbrostar Ferko, Fier, Zona Kadastrale 3980, Pasuria 16/31.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

1.IMPORT-EXPORT mallra te ndryshem.

2.Parkim Automjetesh.

3.Agjenci imobiliare. Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi per pasurite e paluajtshme nepermjet nënshkrimit të nje kontrate te veçante Franchising, aktivitet ndërmjetësimi per pasuritë e paluajtshme.

4. Aktivitet ne fushën e pasurive të patundshme, vlerësimin e pasurive te patundshme, te angazhohet ne shitjen me shumicë dhe pakice të çdo lloj pasurie dhe te hap dyqane, dege apo zyra po te jete e nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkepronesise në prona dhe ndertesa. Per dhenien me qira, nen qira te ambienteve te ndryshme.

5. Aktivitet ne fushen e projektimit te godinave civile, mirembajtje dhe restaurim të objekteve te ndryshem.



6. Organizimi i eventeve, panairove, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjetër artistik dhe televiziv të çdo forme. Konsulencë financiare, ekonomike, juridike që ka lidhje me biznesin, me aktivitetet të ndryshme tregtare të personave fizik dhe juridik përfshirë institucione financiare dhe ato shtetërore.

7. Ndërmjetësim në lidhje me shitje të produkteve të ndryshme.

8. Investime në fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit të pasurive të pa luajtshme.

9. Transportim mallrash, shërbime të ndryshme të lidhura me këtë aktivitet.

10- Aktivitet në fushën e pastrimit dhe higjenes së ambjentëve.

11. Shërbime në fushën e hotelerisë, Bar-Restorant, dhenie me qera e automjeteve dhe çdo shërbim tjetër në fushën e turizmit.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100,000** lekë.

Kapitali i shoqërisë është **100,000** leke i përbërë nga 1 kuotë dhe zotërohet nga ortakut i shoqërisë si më poshtë :

1. Ortaku Themelues: **ARBRI FERKO**, zotëruar i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme **100,000** Leke, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë, Vlera totale e Kapitalit të Regjistruar **100,000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit të Paguar **100,000 Leke**, do të paguhet në avance nga ortakut i vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakut përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tregtimit deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut të vetëm themelues është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të vetëm është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Ortakut të vetëm brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin



dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i cili do të jetë **ARBRI FERKO**, i biri i Resmi(ut) i datelindjes 12-09-1988, i lindur në Fier dhe banues Fier, lagj. Mbrostar Ferko, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr. Personal **035131454**, leshuar nga MB Tirane me datë **18-11-2019**.

Emerimi i administratorit është me një afat pesë vjeçar me të drejtë rimerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakët që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jenë

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto rast Asambleja e Ortakut të vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligji për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta



juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **VITAL INVEST Shpk**, nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I SHOQËRISË

Arbri Fecko

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of a horizontal line with a large loop and a diagonal stroke crossing it.